



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

K.DH.SH.II.nr.1370/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS - Dhomat e Shkalles se Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, ne çështjen juridike përmbarimore të kreditorit MCM Travel Agency, me seli ne rr. “Nena Terezë” pn, ne Prishtinë, kundër debitorit NTSH Vol Travel me seli ne rr.”Xhemajl Mustafa” nr.107 ne Gjilan, me bazë juridike përmbarimore, duke vendosur lidhur me ankesën e kreditorit, e paraqitur kundër aktvendimit të Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhoma e Shkallës se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.117/2023 datës 11.07.2023, me datën 28.05.2024, mori këtë:

**A K T V E N D I M**

Refuzohet e pabazuar ankesa e kreditorit MCM Travel Agency, me seli në rr. “Nena Terezë” pn, ne Prishtinë, ndërsa aktvendimi i Gjykatës Komerciale te Kosovës-Dhoma e Shkallës se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, KPPP.nr.117/2023 i datës 11.07.2023, Vërtetohet.

**A r s y e t i m**

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhoma e Shkallës se Parë- Departamenti për Çështje Ekonomike, me aktvendimin e ankimuar KPPP.nr.117/2023 dt.11.07.2023, e ka pranuar si te bazuar prapësimin e debitorit NTSH Vol Travel me seli ne rr.”Xhemajl Mustafa” nr.107 ne Gjilan, ndërsa urdhrin përmbarimor P.nr.607/2021 dt.17.03.2021 i lejuar nga Përmbaruesi Privat Destan Bujupaj me seli ne Prishtinë, e ka shfuqizuar.

Kundër këtij aktvendimi, në afatin ligjor ka paraqitur ankesë kreditori, pa precizuar bazat e veçanta ligjore, me propozim që gjykata e shkalles se dytë ta aprovoj ketë ankesë si te bazuar, aktvendimin e ankimuar ta anuloj dhe çështjen ta kthej ne rivendosje.

Dhoma e Shkalles se Dytë e Gjykatës Komerciale, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar, pretendimet ankimore dhe pas vlerësimit të tyre në kuptim të dispozitës së nenit 208 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) e lidhur me nenin 17 të Ligjit për Procedurën Përmbarimore (LPP), gjeti se:

-Ankesa e kreditorit është e pathemeltë

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori “MCM Travel Agency”, me seli ne rr. “Nena Terezë” pn, ne Prishtinë, me datën 16.03.2021, ka paraqitur propozim për përmbarrim ndaj debitorit NTSH “Vol Travel” me seli ne rr.”Xhemajl Mustafa” nr.107 ne Gjilan, në bazë të dokumentit të besueshëm-Faturës nr.12 dt.12.06.2017. Përmbarruesi Privat Destan Bujupaj nga Prishtina, duke vepruar sipas propozimit te kreditorit, me urdhrin përmbarrimor P.nr.607/21 dt.17.03.2021, ka lejuar përmbarrimin, me të cilin detyrohet debitorit që kreditorit në emër te borxhit nga fatura t’ia paguaj shumen prej 1,192.00 euro, me kamatë prej 8 % si edhe shpenzimet e përmbarrimit.

Kundër urdhrin përmbarrimor, personi B.L. ka paraqitur prapësim me datë 01.04.2021, përmes se cilit deklaron se e njëjta është divorcuar me ish bashkëshortin H.L.-debitor ne këtë çështje dhe se biznesi Vol Travel është shuar. Meqë urdhri është dashtë ti dorëzohet personalisht debitorit e jo kësaj, e njëjta shprehet se nuk mban përgjegjësi as ligjore e as morale ndaj asnjë obligimi qe ka apo pretendohet te këtë Vol Travel, propozon qe gjykata ta aprovoj prapësimin e zonjës B.L. dhe urdhrin përmbarrimor ta shfuqizoj.

Përgjigje ne prapësim ka bërë kreditori me datën 02.04.2021, përmes se cilës pretendon se janë te pabazuara arsyet e dhëna nga B.L. ne prapësim sepse e njëjta nuk ka sjellë asnjë dokument me te cilin vërteton se është divorcuar nga ish bashkëshorti H.L., thotë qe shkresat e lëndës janë dorëzuar ne mënyrë te rregullt nga zyrtari i postes ne adresën e Vol Travel adresë kjo e vërtetuar edhe përmes Agjencisë për regjistrim te Bizneseve. Propozon qe gjykata ta refuzoj ne tërësi prapësimin e zonjës B.L., ne kuptim te nenit 73 par.1 dhe 23 te LPP.

Gjykata Komerciale e Kosovës-Dhomat e Shkalles se Parë, pas vlerësimit të prapësimin dhe përgjigjes ne prapësim, ka nxjerr aktvendim KPPP.nr.117/2023 dt.11.07.2023, me të cilin ka vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktvendimit të atakuar. Në arsyetim të aktvendimit të atakuar gjykata ka theksuar se nga fletë kthesa nr.607/21 e Përmbarruesit Privat rezulton se i njëjti urdhrin përmbarrimor e ka dorëzuar ne adresën Xhemajl Mustafa nr.107 ne Gjilan me datën 23.03.2021 pra pikërisht ne adresën e debitorit te regjistruar ne ARBK. Mirëpo nga kjo fletët kthesë del se zonja B.L. e ka pranuar propozimin, urdhrin dhe provat tjera te bashkangjitura, ne këtë rast nuk kemi te bëjmë me dorëzim personal ashtu siç parasheh neni 47 par.1 i LPP dhe neni 18 i LPP. Gjykata i referohet ne këtë rast nenit 110 par.2 dhe 3 te LPK dhe nenit 111 par.1 dhe 2 te LPK. Arsyeton se Përmbarruesi Privat urdhrin përmbarrimor duhet t’ia dorëzoj personalisht debitorit ose përfaqësuesit ligjor te autorizuar ndërsa nëse ky i fundit nuk gjendet ne atë adresë atëherë zyrtari i angazhuar nga Përmbarruesi Privat duhet te marr informacionet se kur dhe ku do te jetë marrësi dhe t’ia lë njoftimin marrësit përmes personave madhor familjar lidhur me vendin dhe kohen për dorëzim te urdhrin debitorit dhe nëse përsëri marrësi nuk gjendet ne adresën e tij atëherë Përmbarruesi Privat mund qe urdhrin t’ia dorëzoj një personi madhor familjar te debitorit ose punëtorit ne vendin e tij te punës. Andaj ne rastin konkret Përmbarruesi Privat urdhrin ia ka dorëzuar zonjës B.L. e jo debitorit, ndërsa nga shkresat ne lende nuk rrjedh se përmbarruesi e ka

njoftuar debitorin për kohën se kur duhet të jete në adresën e tij përmes ndonjë personi të rritur të familjes së debitorit. Në shkresat e lëndës me tej nuk rezulton se zonja B.L. ka qenë e autorizuar që ta beje pranimin e urdhrin qoftë në bazë të prokurës, marrëdhënies së punës ose ndonjë baze tjetër, andaj nga këto rrethana del se urdhri nuk është bere sipas kërkesave ligjore të LPK rrjedhimisht debitorin është privuar nga e drejta për një proces të rregullt. Gjykata vlerëson se në rastin konkret do të duhej të zbatohet neni 114 i LPK duke iu referuar kështu edhe nenit 277 par.1 pika c) e LPK, duke vendosur kështu si në dispozitiv të këtij aktvendim.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykatës Komerciale, vlerëson se gjykata e shkallës së parë, në bazë të provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, ka dhënë aktvendim të drejtë dhe të bazuar në dispozita konkrete ligjore, duke vlerësuar po ashtu se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182, paragrafi 1 dhe 2 dhe nenit 183 të LPK-së, dhe se drejtë është vërtetuar gjendja faktike, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton edhe sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Nisur nga kjo gjendje e çështjes, Gjykata Komerciale – Dhoma e shkallës së dytë, vlerëson se gjykata e shkallës së parë i ka zbatuar drejtë dispozitat e Ligjit të Procedurës Përmbartimore me rastin e vendosjes. Përkitazi kësaj çështje edhe gjykata e shkallës së dytë bazuar në shkresat e lëndës gjegjësisht nga fletë kthesa për dorëzim personal nr.607/21 e dorëzuar nga Përmbartuesi Privat në adresë të debitorit rr.”Xhemajl Mustafa“ nr.107 në Gjilan, me datën 23.03.2021 rezulton se këtë fletë kthesë nuk e ka pranuar personi i autorizuar i debitorit. Edhe kjo gjykatë në lidhje me këtë çështje vlerëson se Përmbartuesi Privat nuk ka vepruar konform dispozitave ligjore në mënyrë që fletëkthesa të pranohet nga përfaqësuesi i autorizuar i debitorit dhe jo nga ndonjë person tjetër ashtu siç parashohin dispozitat ligjore. Neni 47 par.1 i LPP parasheh që: *“Për dorëzimin e aktvendimit për përmbartim apo urdhrin për përmbartim zbatohet neni 18 i këtij ligji.* Po ashtu kjo gjykatë vlerëson nenin 110 par.2 dhe 3 të LPK dhe nenin 111 par.1 dhe 2 e LPK , gjë që në rastin konkret Përmbartuesi Privat nuk ka vepruar në pajtim me këto dispozita ligjore sepse bazuar nga shkresat në lëndë nuk rezulton që ta ketë njoftuar debitorin përmes ndonjë personi madhor ose familjar lidhur me vendin dhe kohën kur i njëjti duhet të jete i disponueshem në mënyrë që Përmbartuesi Privat që t’ia dorëzoj urdhrin, dhe me pastaj pas tentimeve për dorëzim sipas këtyre dispozitave Përmbartuesi t’ia lë një personi madhor familjar të debitorit fletëkthesën, fqinjit ose punëtorit tjetër në vendin e punës së debitorit. Pra nga shkresat e lëndës Përmbartuesi Privat ia ka dorëzuar urdhrin përmbartimor me shkresa tjera të bashkangjitura zonjës B.L. dhe jo debitorit edhe pse e njëjta nuk ka qenë e autorizuar ta beje pranimin urdhrin as në bazë të prokurës e as nga ndonjë raport tjetër. Në këtë rast edhe kjo gjykatë vlerëson nenin 114 të LPK i cili parasheh që: *“Në qoftë se dorëzimi i shkresës subjektit të regjistruar në regjistrin publik nuk mund t’i bëhet në adresën e treguar në regjistër, komunikimi bëhet duke u ngjitur shkresa në tabelën e shpalljeve të gjykatës, dorëzimi konsiderohet i kryer pas skadimit të afatit prej shtatë ditësh nga dita e afishimit në tabelën e shpalljeve të gjykatës”,* gjë që nga shkresat në lëndë nuk rezulton se Përmbartuesi Privat ka vepruar në pajtim me këtë dispozitë ashtu që shkresën ta afishoj në tabelën e shpalljes.

Andaj bazuar ne këto arsye gjykata e shkalles se dytë vlerëson ne tërësi përfundimin juridik te gjykatës se shkalles së parë.

Gjykata e shkallës së dytë analizoi edhe pretendimet ankimore te kreditorit por te njëjtat i konsideroj si jo relevante për një vendosje ndryshe nga ajo qe ka vendosur gjykata e shkalles se parë, andaj këto pretendime i refuzoi si te pabazuara ndërsa aktvendimin e atakuar e vërtetoj.

Kompetenca e Dhomës se Shkalles se Dytë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual bazohet në dispozitën e nenit 3 paragrafi 2 të LPP-së, me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga të gjitha arsyet e paraqitura e në pajtim me dispozitat e nenit 208 dhe 209 paragrafi 1 pika (b) të LPK lidhur me nenin 17 të LPP, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

## GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS

Dhomat e Shkallës së Dytë

K.DH.SH.II nr.1370/23 me datë 28.05.2024

Gjyqtari,  
Krenar Berisha